



Planuar / Dorezuar Prilaps / Predato Received / Delivered	19-04-2023	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	In Prof In Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMISHCK	3689/2023		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OF THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.470/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari-dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.470/2023 të datës 08.03.2023 të parashtruar nga ankuesja, , kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.470/2023 e datës 08.03.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në Komunën e Suharekës sipas akt emërimit të datës 28.12.2011 me nr.01-Nr.58, më datë 08.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë – Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me kategorizimin e pozitës së saj të punës në Kategorinë Profesionale 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Suharekës, ndërsa me datë 22.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:



Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Aktin e Emërimit me numër reference 01-Nr.58 të datës 28.12.2011, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare për programin e sistemit të PIP-it në kuadër të Drejtorisë për Planifikim , Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari, me koeficient të pagës, gjashtë (6), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesja, me datë 08.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë - Ministria e Punëve të Brendshme, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me datë 05.02.2023, ka kategorizuar ankuesen në Kategorinë Profesionale 3, përkundër se e njëjta i plotëson të gjitha kushtet ligjore për Kategorinë Profesionale 1, të parashikuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërsa nga përmbajtja e shkresave të lëndës kolegji i këshillit nuk ka gjetur asnjë shkresë të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB që ka vendosë në lidhje me këtë çështje konkrete përveç një shkrese më datë 14.03.2023 të dërguar nga institucioni përkatësisht komuna e Suharekës në adresë të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë-MPB, për korrigjimin e koeficienteve të pagave që lidhet edhe me pretendimin e ankueses, pasi kjo ankesë ishte adresuar në këshill më datë 08.03.2023, andaj mbi këtë bazë ankesa është e palejuar në këshill.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit poashtu analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/fit në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Suharekës, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe





katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë profesionale 1 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim merititor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në at që u tha më lartë vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.470/2023, datë 19.04.2023

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

